



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	31-01-2024	4	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRMSTK	622/2024		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1478/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1478/2023 të datës 05.12.2023 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat

me adresë:

kundër

Vendimin me Nr. 6492 të datës 07.11.2023 të Komisionit të Vlerësimit të Nivelit Drejtues në kuadër të Agjencisë Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 30.01.2024 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr. 1478/2023 e datës 05.12.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr. 6492 i datës 07.11.2023 i Komisionit Vlerësues i Nivelit Drejtues në Agjencinë Pyjore të Kosovës.

A r s y e t i m

Agjencia Pyjore e Kosovës me date 11.09.2023 ka publikuar njoftimin lidhur me hapjen e konkursit me numër reference RN00012458 për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Planifikim, Inventarizim, Plane Menaxhuese, Kadastër Pyjor, Këshillime dhe Koncesion", ku konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 26.09.2023 deri me datën 04.10.2023, në të cilin konkurs ka aplikuar ankuesi me datë 27.09.2023, sipas aplikacionit me numër Reference RN00012458 i cili ka marr pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit.

Pas përfundimit të procesit të të gjitha fazave të vlerësimit me datë 27.10.2023 Agjencia Pyjore e Kosovës publikon renditjen përfundimtare të kandidatëve ku rezulton se ankuesi nga vlerësimi i testit me shkrim ka marr gjithsej 45 pikë, nga vlerësimi i jetëshkrimit 18.67 pikë dhe nga intervista me gojë gjithsej 7 pikë që në total të pikëve janë gjithsej 70.67 pikë, ndërsa kandidati tjetër i cili konsiderohet kandidati fitues nga vlerësimi i testit me shkrim ka marr gjithsej 56 pikë, nga vlerësimi i jetëshkrimit ka marr gjithsej 16.33 pikë dhe nga intervista me gojë gjithsej 6.33 pikë e që në total me gjithsej 78.66 pikë, ku edhe konsiderohet si kandidati me më së shumti pikë.

Ankuesi i pa kënaqur me vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, më datë 01.11.2023 ka parashtruar ankesë pranë Komisionit të Vlerësimit të Nivelit Drejtues në Agjencinë Pyjore të Kosovës, ndërsa Komisioni i Vlerësimit të Nivelit Drejtues në Agjencinë Pyjore të Kosovës më datë 07.11.2023, ka nxjerr Vendim me Nr. 6492, përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar, duke e lënë në fuqi renditjen e kandidateve sipas vlerësimit të Komisionit Vlerësues të Nivelit Drejtues.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 6492 të datës 07.11.2023 të Komisionit Vlerësues të Nivelit Drejtues në Agjencinë Pyjore të Kosovës, përmes përfaqësuesit me autorizim, me datë 05.12.2023 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 7232/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit te Agjencia Pyjore e Kosovës, ndërsa me datën 14.12.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me datë 16.01.2024 Kryesuesi i Këshillit ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2023 dhe numër protokollit 277/2024, përmes së cilit ankesës së ankuesit A.nr.1478/2023 të datës 05.12.2023 i ka vazhduar afatin vendimmarrjes për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 7232/2023 të datës 05.12.2023 të parashtruar nga ankuesi përmes përfaqësuesit me autorizim në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 24.11.2023; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulet dhe Profesional të datës 10.01.2023; Akt-in e emërimit me numër 4098 të datës 09.10.2019 të nëpunësit Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publik për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulet dhe Profesional të datës 27.01.2022; Akt-in e emërimit nën shenjë A.E.Nr.02/2022 të datës 07.07.2022 të kandidatit Vërtetimin e datës 04.10.2023 lëshuar nga Menaxheri i Personelit në Komunën e Dragashit; Certifikatën e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin Menaxhimi i Kontratës përmes e-Prokurimit për periudhën kohore 20-21.05.2021; Deklaratën me numër reference REF.SBNJD-97/2023 të datës 02.10.2023 të lëshuar nga Menaxherja e Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës; Listën e

Distribuimi-t të datës 30.09.2021; Vendimin me numër 6925 të datës 20.11.2023 të lëshuar nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës; Kërkesën për udhëtim zyrtar për periudhën kohore 09.10.2023 deri me 13.10.2023; Raportin për Vizitë të datës 23.10.2023; Emalin e datës 09.12.2023; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulet dhe Profesional të datës 11.01.2022; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publik për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulet dhe Profesional të datës 18.01.2023; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulet dhe Profesional i datës 31.12.2022; Kontratën e Punës me numër Ref.NFG-54/12 të datës 28.09.2012 se ankuesit; Akt-in e emërimit me numër SBNJD-140/2015 të datës 19.05.2015 të ankuesit; Vendimin me numër 3987 të datës 12.09.2022 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për transferimin e përkohshëm të Vendimin me numër Ref:KR-774/22 të datës 11.10.2022; Vendimin me numër Ref:KE-137/23 të datës 02.03.2023 lidhur me caktimin e ankuesit ne pozite "Udhëheqësit të Spektorit për Planifikim Invertarizim, Plane Menaxhuese, Kadaster Pyjore Këshillim dhe Konsesionim" në Agjencinë Pyjore të Kosovës; Raportin e Sinjalizuesit me numër protokolli 3756 të datës 26.09.2023; Referencën e datës 19.03.2015 të lëshuar nga Natyral Resources Solution; Certifikatën e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administrate Publike lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin Mbrojtja e Sinjalizuesve për periudhën kohore 13-14.Dhjetor. 2022; Certifikatën e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administrate Publike lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin Menaxhimi i Kontratës përmes e-Prokurimit për periudhën kohore 20-21.Maj 2021; Certifikatën lidhur me përfundimin me suksese për gjashte muaj në modulën Entrepreneurship- Mikro Enterprise Training Progi të lëshuar nga USAID; Diplomën me numër 1561 të datës 24.10.2011 të lëshuar nga Universiteti i Bujqësisë në Tirane; Vendimin me numër Ref.Nr.6-1513 të datës 02.05.2017 të lëshuar nga Kryesuesja e Këshillit Shtetëror për Njohje ne Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në Prishtinë; Konkursin me numër reference RN00012458 të datës 11.09.2023 për pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit për Planifikim, Invertarizim, Plane Menaxhuese, Kadaster Pyjore, Këshillim dhe Konkension" në Agjencinë Pyjore të Kosovës; Autorizimin me numër Ref.DMP-09/2023 të datës 30.01.2023; Autorizimin me numër Ref.DMP-82/2023 të datës 15.05.2023; Autorizimin me numër Ref.DMP-143/2023 të datës 31.08.2023; Autorizimin me numër Ref.DMP-176/2023 të datës 10.11.2023; Autorizimin me numër Ref.DMP-108/2023 të datës 16.06.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 1478/2023 të datës 08.12.2023; Njoftimin me numër protokolli 4220 të datës 05.10.2023 të Njësisë së Burimeve Njerëzor në Agjencinë Pyjore të Kosovës; Njoftimin me numër protokolli 6408 të datës 30.10.2023 për kandidatin e përzgjedhur; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 27.10.2023; Vendimin me numër protokolli 4775 të datës 11.10.2023 për emërimin e Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyre; Aplikacionin e ankuesit të datës 27.09.2023; Dokumentin e identifikimit; Vërtetimin me numër Ref.SBNJD-75/2023 të datës 22.08.2023 lidhur me përvojën punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës; Vendimin me numër reference Ref:KE-665/22 të datës 12.09.2022 për plotësim ndryshimin për transfer të përkohshëm në Kontratën e punës me numër Ref:NFG-54/12 te datës 28.09.2012; Aktin e emërimit me numër SBNJD-140/2015 të datës 19.05.2015; Aplikacionin e datës 04.10.2023 të kandidatit Diplomën me numër 1946 të datës 01.11.2019 me të cilën dëshmohet se kandidati ka përfunduar studimet themelore në Universitetin Bujqësorë të Tiranës; Vendimin me numër Ref.Nr.614-671 të datës 19.02.2020 lidhur me njohjen e gradës "Bachelor në Mareshtim Pyjesh" të lëshuar nga

Kryesuesja e Këshillit Shtetërorë për Njohje; Vërtetimin (pa numër) të datës 28.09.2023 lidhur me përfundimin e studimeve master profesional në formën e studimit me kohë të plotë; Dokumentin e identifikim; Vërtetimin e datës 04.10.2023 të lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Dragashit; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Njësive Civile dhe Njësive të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulet dhe Profesional të datës 27.01.2022; Formularin për vlerësimin e Rezultateve në Punë të Njësive Civile dhe Njësive të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm i Ulet dhe Profesional të datës 10.01.2023; Certifikatën e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin Menaxhimi i Kontratës përmes e-Prokurimit të mbajtur me date 20-21. Maj.2021; Shkresën lidhur me vlerësimin e testimit me shkrim, jetëshkrimin dhe intervistës me gojë të datës 01.11.2023; Vendimin me numër protokoll 6492 të datës 07.11.2023 të Komisionit Vlerësues të Nivelit Drejtues; Vendimin me numër protokoll 277/2024 të datës 16.01.2024 lidhur me vazhdimin e afatit për vendosje të lëshuar nga Kryesuesi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, *sepse*:

Ankuesi, në ankesën e parashtruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.6492 të datës 07.11.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë, pretendon se anëtarët e Komisionit Vlerësues nuk janë ekspertë të fushës së lëmis së pylltarisë, përbërja e Komisionit nuk ka qenë profesionale dhe në kundërshtim me nenin 17 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, me çka ka rrjedh se vlerësimi i intervistës me gojë nuk është bërë në mënyrë të drejtë ngase ankuesi ka gradën Master në pylltari dhe përvojë punë 10 vjeçare në plane menaxhuese; Vlerësimi i Jetëshkrimin nuk ka qenë në përputhje me rregulloren përkatëse sepse ka qenë totalisht tendencioze ngase duke marr parasysh përvojën e punës së ankuesit vlerësimin me vetëm dy pikë më shumë se kandidati fitues është tendencioz duke marr parasysh se ankuesi është ushtrues detyre i kësaj pozitë nga shtatori i vitit 2022; Kështu që kjo procedurë është përcjell me shkelje ligjore që kanë qenë në dëm të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se sipas Konkursit me Nr. Reference: RN00012458 për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Planifikim, Inventarizim, Plane Menaxhuese, Kadastër Pyjor, Këshillime dhe Koncesion", si kriteret të përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në Pylltari;*
- *Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.*
-

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se përbërja e Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë ka qenë në kundërshtim me legjislacionin përkatës ngase nuk janë ekspertë të fushës së lëmis së pylltarisë dhe nuk janë profesional, Kolegji i Këshillit, sjell në vëmendje se sipas nenit 59 paragrafi 3 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, përcaktohet se: "KVND ka në përbërje këta anëtarë: 3.1. një përfaqësues i Njësies Përgjegjëse (DMZP-ja për institucionet e administratës shtetërore apo Njësia e Burimeve Njerëzore të Institucionit për

institucionet e tjera shtetërore) i specializuar në teknikat e përzgjedhjes. 3.2. një përfaqësues nga NJBNJ e vetë institucionit që ka pozitën e lirë; 3.3. një nëpunës civil i kategorisë të lartë drejtuese të vetë institucionit apo të një institucioni tjetër të shërbimit civil, me përgatitje të veçantë në procedurat e përzgjedhjes”, me çka rrjedhë se sipas vendimit Ref.DE-745/2023 të datës 11.10.2023 është emëruar Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrës, ku kryesuesi i Komisionit ka qenë zëvendësuesi i Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, njëri nga anëtarët ka qenë Zyrtare e Lartë për politikë të Personelit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë dhe tjetra ka qenë Menaxhere e Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës, ndërsa edhe anëtarët zëvendësues kanë qenë në të njëjtin nivel përveç që si zëvendësuese e Menaxheres së Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës ka qenë Zyrtarja e Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, duke ju referuar dispozitës ligjore të aplikueshme në këtë procedurë, vendimit për emrimin e Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë, konstaton që ky komision është themeluar në plotëni me dispozitën e cekur si më lartë duke plotësuar të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 59 paragrafi 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që pretendimi i ankuesit se ky komision është themeluar në kundërshtim me nenin 17 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës është i pabazuar, ngase ky nen aplikohet vetëm tek pranimin në shërbimin civil jo edhe tek procedura e ngritjes në detyrë, kështu që kjo rregullore nuk ka parashikuar që përshtatshmërisht mund të aplikohen dispozitat e nenit 17 me rastin e emërimit të Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në detyrë.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit, se vlerësimi i intervistë me gojë nuk është bërë në mënyrë të drejtë ngase ankuesi ka gradën Master në pylltari dhe përvojë punë 10 vjeçare në plane menaxhuese, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas kërkesave të përgjithshme formale të konkursit nuk është kërkuar që kandidatët të kenë përgatitje profesionale Master, mirëpo është kërkuar diplomë e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve, rrjedhimisht, në bazë të aplikacionit të ankuesit por edhe të kandidatit me më së shumti pikë, rezulton se të dy kandidatët kanë përgatitje arsimore të kërkuar në konkurs, ndërsa sa i përket përvojës së punës, Kolegji i Këshillit, konstaton se të dy kandidatët në bazë të dokumentacionit të ofruar plotësojnë këtë kriter ngase kanë përvojën e punës profesionale siç ka qenë edhe kërkesë e konkursit dhe janë kërkesa të parashikuara me rregulloren përkatëse për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil. Tek hapi i vlerësimit të jetëshkrimit aplikohet neni 61 i Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ndërsa nuk aplikohet neni 22 në të cilën ju referohet ankuesi në ankesën e tij, ngase neni 22 aplikohet për procedurën e pranimit në shërbimin civil, kështu që duke marr parasysh përgatitjen profesionale/arsimimin, përvojën e punës profesionale dhe dëshmitë e trajnimeve, Kolegji i Këshillit, konstaton se vlerësimi i jetëshkrimit për këtë pozitë për ankuesin dhe kandidatin me më së shumti pikë është bërë në pajtim me nenin 61 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: “1. Pas testimit me shkrim, KVND, kryen vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve. 2. Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe rezultateve të arsimit, të përvojës domethënëse në punë dhe të trajnimeve dhe kualifikimeve domethënëse për punën. 3. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri njëzet (20) pikë, si vijon: 3.1. tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin e arsimit; 3.2. shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë, dhe 3.3. pesë (5) pikë për trajnimet dhe kualifikimin. 4. Secili nga anëtarët e KVND, bën vlerësimin e detajuar për secilin prej faktorëve të përcaktuar në paragrafin. 3 të këtij neni. Vlerësimi është mesatarja vlerësimeve e të gjithë anëtarëve”, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar, sepse nuk është argumentuar me prova

materiale se ka pasur vlerësim jo real dhe jo të drejtë.

Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimi i provave të lëndës, respektivisht ndërlidhur me vlerësimin e kandidatëve në fazën e testit me shkrim, jetëshkrimit dhe intervistës me gojë, konstaton se testimi me shkrim është elektronik dhe kandidatët vlerësohen në bazë të përgjigjeve të dhëna, ndërsa vlerësimi bëhet sipas sistemit elektronik, sa i përket vlerësimit të jetëshkrimit, Kolegji i Këshillit, sipas arsyetimit të cekur si më lartë, konstaton se vlerësimi i jetëshkrimit për ankuesin dhe kandidatin me më së shumti pikë është bërë mbi bazën e provave të dërguar nga palët, ndërsa vlerësimi i intervistës me gojë është vlerësim diskrecional i Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë, ngase ky vlerësim bëhet në bazë të vlerësimit të përgjigjeve që bënë komisioni, kështu që marr parasysh këtë Kolegji i Këshillit, konstaton se vlerësimi i kandidatëve është bërë në pajtim me nenin 60, 61 dhe 62 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që mbi bazë të konstatimeve si më lartë, Kolegji i Këshillit, nuk ka evidentuar ndonjë shkelje procedurale dhe materiale në këtë procedurë, si rezultat i kësaj kjo procedurë e avancimit në karriere është zhvilluar në pajtim me nenin 39 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 4 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: *"1. Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë. 2. Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuara në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore"*, kështu që pretendimi i ankuesit se kjo procedurë është përcjell me shkelje ligjore që kanë qenë në dëm të ankuesit është i paqëndrueshëm.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisionit Vlerësuese i Nivelit Drejtues në Agjencinë Pyjore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr. 6492 të datës 07.11.2023, ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit, duke vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe vendimi është nxjerr edhe konform kompetencës së parashikuar me nenin 50 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1478/2023, datë 30/01/2024

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të palës ankuese, Avokat
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Pyjore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.